


Emira Ibishi

Në Heshtje



EMIRA IBISHI

NË HESHTE

Prill
2022

Poezi

Nën dritën e hënës

*Diçka e vogël në jetë ndryshon
diçka shumë të
madhe*

Ajo ditë

*Ajo ditë e pa harruar,
Ajo ditë e shumë herë kujtuar,
Ajo ditë me plotë mall,
Ajo ditë me ëndje,
Si asnjeherë më parë,
Ajo ditë me emocione shumë,
Ajo ditë me syrin pa gjum,
Ajo ditë, ngelet ajo ditë,
E do jetë një sekret i rrallë,
I menduar shumë me mallë.
Ajo ditë shumë e uruarr,
Ajo ditë shumë herë e kërrkuar.*

Më ndihmo

Kur kam vërtetë nevojë

-Më ndihmo,

Pa më pyetur pse

Më ndihmo pa ndonjë arsye

-Me ndihmo,

Dhe më larho nga terri i asaj erësire

-Me ndihmo,

Ku po përballem me friken time

-Me ndihmo,

Kur po luftoj me pikën e dobsisë time

-Me ndihmo.

Pranoja vetes

*Pranoja vetes
Që ti mundesh
Pa marr parasysh pengesat,
Ti mund të rringrihesh
Pa marr parasysh
Nëse jeta t'i sjell njëqind dështime,
Për të mos vazhduar
Ti të gjitha mund ti tejkalosh,
Ti përseri gjej njëqind të mira për të vazhduar,
Ti vetëm duhet të kesh kurajo
Ti poashtu duhet të kesh durrim,
Me kohë do të bëhet gjithçka,
Dhe asnjëherë mos i humb shpresat,
Ëndëro se një ditë
Çdo ëndër do bëhet realitet,
Dhe se çdo e mirë do gjej vendin e vetë.*

Ankth

*Atë ditë pash gjithçka
Nuk mund të flisja,
Më kaploi frika
Nuk mund të lëvizja.*

*Në atë moment
Doja vërtetë NDIHMË
Shikoja rreth e rrotull ,
Isha vetem unë me qetësinë.*

*Në atë moment
Doja të bërtas,
U zgjova nga makthi
Që atë natë e pashë.*

Koha

*Sa shpjetë kalon kjo kohë,
Farre pa u menduar,
E menjëhere duhet vepruar.*

*E jo çdo gjë
Zgjat përgjithmonë,
Gjithçka në këtë botë
Është e përkohshme .*

*Kjo kohë është një orë e heshtur
Është një lum i rëmbyshtëm
Që dy herë s'mund prekur.*

*Koha tregon gjithçka me rëndësi,
Tregon të vërtetën,
Por jo në kohën e vendin e duhur,
Pastaj del e vërteta e shumë kërkuar.*

Sa vite kaluan

*Sa vite kaluan,
Unë ty po të pres,
Eja sa më shpejt,
Mos e lë në shpresë.*

*Sa vite kaluan,
O tim bir,
The se do vije,
Apo toka e mërgimit,
Të ka përbijë.*

*Harove nënën që të rriti
Më shumë mund,
Harrove lotët që derdhën këto sy,
Kthehu të të shoh, ty o bir.*


*Mos e le kohën,
Që të kaloj,
Se më vonë,
Mund t' mos jetoj.*

*Eja, t' shuaj mallin,
Që kam për ty,
Mos i lë hapur këta sy.*

Nëna

*Ajo që të do çdo të mirë,
Ajo që të ndihmon në çdo vështërsi,
Ajo që naten ta bën dritë,
Është vetëm Nëna yllë e dritë.*

*Prehëri i saj çdo dhimbje qetëson,
Fjala saj shumë bukur tingëllon,
Një zemër e ëmbel me dashuri,
E shtrejtë e pa krahasueshme je vetëm ti.*



Gjuha e heshtje

*Ditët ecin
Një nga një,
Na mbesin fjalë
Të vërteta jo.*

*Ndonjëherë na lind një shpresë
Në jetë na motivon,
Por kur humbet një shpresë
Duket sikur gjithçka mbaron.*

*Duke vështrur gjithandej
Lirshëm i bëja dialog vetes,
Ndonëse më vinte të bërtisja
Pajtohesh me gjuhën e heshtjes.*

Poezia

*Nuk flas dot me zë,
Por flet poezia,
Flet vargu resht më resht,
Vargu i vetë krijuar.*

*Kjo poezi me kuptim shumë
E me fjalë që dain nga zemra,
Me fjalët e shpirtit,
Të gjitha të vërteta.*

*Shkruaj poezi kur veten dëgjoj
Vetë fjalët që thur zemra,
Në shpirtin tim gjej një ndryshim
Nuk ndjej me barrë por një lehtësim .*

*Një lehtësim nga të hidhurat kujtime,
Ku do doja nga fillimi t'ia filloj,
Fjala vuajtje mos ekzistoj.*

*Sonte duke shkruar nuk do ndaloj,
Sepse gjithçka brenda meje dua t'kaloj.*

Koha

*Sa shpejtë kalon kjo kohë,
Fare pa u menduar,
E menjëherë duhet vepruar.*

*E jo çdo gjë zgjat përgjithmonë,
Gjithçka në këtë botë,
Është e përkohshme,
Por askush nuk e kupton,
Faktin kryesor të kësaj bote.*

*Të gjithë gjithçka dimjë,
Por nuk mund ta pranojmë,
Faktin e së vërtetës,
Në fund të trishtë apo të lumtur,
Gjithçka do mabroj,
Edhe dielli që lind do perendoj...*



Qëllimi i pambaruar

*Sikur dielli qe ndriçon
Zemerën time e mburron,
Një mburrje me shumë shpresë
Sa të jetë unë do e mbështes.*

*Një ëndër e thurur
Shumë më parë,
S'kishte fuqi e po shuhej
Dalë nga dalë .*

*Ndalu pak ti moj kohë,
Që ca gjëra po ndryshoj,
Imagjinanët e asaj ëndre dua ta harroj.*

*Dua të shpik diçka të re,
Ku të gjithë do e vinin re.*

*E të punoj shumë
Pavarsisht të tjerëve,
Me shumë kurajo
E qëllimit pa mbaruar t'ia arrij në fund.*

Mendime në heshtje

*Ska njeri të pagabueshëm,
Por të përmisueshëm,
E jo të pa arsyeshëm.*

*Kam hyrë në mendime,
Dhe me veten po flas,
A do mund ta them,
Atë që se thash.*

*Në terrin e natës
Ku heshtja mbizotëron,
E shoqëruar me vetminë
Duket sikur gjithçka po kalon.*

Ndoshta

*Ndoshta tani është vonë,
Por një moment i duhur.*

*Ndoshta nëse ndryshoj mendim,
Atëherë mund të kem guximin.*

*Ndoshta hëna s'do shëndris,
Nga fjalët që çdo natë i përshpëris.*

*Ndoshta më mirë gjithçka të harroj,
Se me mendime e kujtime të jetoj.*

*Ndoshta tani mund të flas,
Atë që dikur se thash.*

*Ndoshta një ditë mund të shpresoj,
Se gjithçka do të rregulloj,
Ose gjithmonë e heshtur të qëndroj.*

Gënjeshtra gjatë gjithë jetës

*Mendimet nuk zgjedhin probleme
Vetëm opsione ofrojnë,
Opsione të ndryshme ku duhet të veprojmë
Por ndonjëherë emocionet e tepërta na
dekoncentrojnë.*

*Secili gjithçka ndjen në mënyrën e vetë,
Njerëzit janë shumë të ftohtë,
Çdo ditë e më shumë po largohen,
Më morri malli për kohën e vjetër,
Atëherë kishte këngësi e ndjesi tjetër.*

*Të shkruash me laps e me letër
Është njejtë si në kohën e vjetër,
Të krijosh vargje është sikur të flasesh
Të shprehesh mendim, dhe të gjesh një vendim.*

*Të gjithë gjithçka dimë,
Por nuk mund ta pranojmë faktin e së vërtetës,
E jetojmë me një gënjeshtrë gjatë gjithë jetës.*

Ajo


*E mërzitur shumë nën dritën e hënës,
E nuk mund ta mbante veten,
Që të përballonte të vërtetën.*

*Po mundoheshte çdo herë,
Por shikonte se kot edhe kësaj herë.*

*E kapluar nga ndjenja e frikës drejt lumturisë
E me vete thoshte çfar do të ndodh,
Ajo nuk mund të shpehej as se si,
Vetëm e zhytyr në një tërësi.*

*Ndëgjonte zërin brenda saj,
Që brenda kishte pak shpresë,
Edhe pse e kishte shumë të vështirë
Ajo mundohej që t'ia del.*

*Sa lotët i ridhnin e i thaheshin,
Me ëndrat të shoqëruar,
Por ishin thjesht ëndëra,
Jo diçka e realizuar.*



Për ty


*Kam të të them diçka
Ty që nuk merr guximin të shijosh momentin,
E di që e ke të veshtirë,
E di që nuk ndjehesh mirë,
E di që nuk dëshiron të shoqërohesh e me njerëz,
E di që qanë shumë!!,
Ndoshta jasteku yt, e di me mirë se unë,
Spese po ti numëron lotët çdo natë,
E di që të kanë zhgënjyer shumë njerëz,
Që si prisje të sillen në atë menyrë,
E di që ndehesh vetem, por ti nuk je vetëm,
E di që ndjehesh boshe, por ti zemrën e ke plotë dashuri,
E di që jeton me qiellin ngjyrë gri,
Por dua të të them se po lind dielli
E të bëhet qielli i kaltërt,
Ti do të buzëqesesh e do shijosh çdo moment të jetës
Sepse kryesorja je ti.*

Mendimet

*Në kokë më vinë mendime të turbullta
Por janë mendime të mira,
Nga dështimi arrije tek zgjidhja
Dua të të kam përballë e të të flas,
Ti shuaj kryeshtjet e mia
Që atë ditë nuk ti thash,
E mbytur me gjithçka
Dhe e zhytur shumë thellë,
Dua të jesh pranë edhe një herë.*

Ndjenjat me rrjetë flutrash

*Aty ku mendon se gjithçka përfundoi,
por aty sapo filloi gjithçka.*



Mbase

*Mbase më duhet me kohë të mendohem,
Mbase nuk do pendohem,
Mbase do dëgjoj të tjerë,
Mbase do eci në rrugën e zemres time,
Mbase do kalonin këto fiksime,
Mbase nuk do mundem,
Mbase s'do e takoj më,
Mbase s'do ti dal përballë,
Mbase s'do i them asnjë fjalë,
Mbase një ditë do kaloj,
Por gjithçka brenda meje do përjetoj.*

Rastësitë

*Përsëri me ty,
Përsëri ti,
Ti me del përballë kudo.
Sado që mundohem të iki,
Ti më ndejk si iluzion,
Ti je bërë pjesë e imja,
Kudo që shkoj përsëri ti,
Rastësitë na takojnë,
Rastësitë vërtetë ndonjëherë ekzistojnë,
Edhe se pse gjithçka ndodh për një arsye.*

Dashuri

*Që në mometin kur të pashë
Zemra ime ritëm ndryshoj,
Ehh kur të shikoja nuk mund të ndaloja
Kur buzëqeshje ti, te unë lind shpresë,
Lindi motivi që moti e kisha humbur
U rikthye buzëqeshja sërisht falë teje,
Nuk mund të ndaloj së menduari për ty,
Për ty që në zemër më flen,
Për ty që në gjum rahat nuk më lë,
Këtë nuk di si ta quaj,
Tani apo në ardhmëri,
Apo mos ndoshta ti them thjeshtë, dashuri.*

Udhëpërshkrim

*Atë imazh e kam ende në sytë e mi,
Atë gëzim që nga unë doli,
Atë moment ku dhe ëndra përfundoi.
Ishte imazhi yt që sot çdo qlizë trazoi.
Nuk mund ta mbaj veten nje pa ta thënë,
Dhe mendimeve të mia kahje u jepeje ti,
Dhe jetës sime i jepje kuptim të ri.*

E veçantë

*Ti e di kur jam e vetmuar,
Ti e di kur jam e trishtuar,
Ti e di kur jam e dorëzuar,
Ti e di kur e thyer jam,
Ti e di kur plagë kam,
Dhe ti di si t'mi shërosh,
E veçantë është kur ke
Personin e duhet pranë,
Ti më kupton pa folur,
Motër e vëretë je ti,
Motër deri në përjetësi.*

Shkrime të shoqëruara me lotë

*Po endem për të gjetur diçka
E për të dëgjuar fjalë,
Por vetëm një burrim mund të shuaj etjen time,
Burimin që e kërkiva gjatë gjithë jetës sime.
Malli im po rritet pa fjalë,
Kam frikë hënës e diellit tu dal përball.
Do hesht sepse ndjehem e turpëruar,
Tëre ato ujra duke i trazuar,
Kur të shkruarit bëhet e vetjma
Mënyrë për të marr frymë.
Po ashtu dhe lotët në sy më nuk rrin.*

E vërtetë e hidhur

*Gjithçka merr vlerë kur shkon,
Gjithçka merr vlerë kur e humbasim,
Çdo kush për rreth meje më duket
Si me më shikuar me keqardhje,
Kjo gjë mua më mundon,
Ngadalë e fshehtas dhe loti pikon,
Në netët e gjata të verës,
Dhe brenda vetes shpresa rilind përsëri
Dhe fillon një fillim i ri.*

Ta dije

*Ehh ta dije do ishte ndryshe,
Ta dije që çdo mëngjes kur diellin shoh,
Ty të mendoj,
Ta dije që më zë gjumi duke i folur hënës për ty,
Ta dije se sa të kërkoj,
Ta dije që në çdo sekond mendoj për ty,
Ta dije që lundron në endret e mia,
Ta dije që per mua "Ti je dashuria",
E ta dije sa shumë të dua,
A do më kërkojë dhe ti mua.*

E vetmuar

*Ndihem vetëm, më mungon ti
E di që disa gjera duam ti rikthejm,
Por është vonë
E di që edhe nëse jetoj më shumë se një jetë,
Si ti kurrë s'do kisha gjetë.
Që herën e parë kur të pash
Zëri im filloi të dridhej, e nuk munda të flas,
Kur të pash ty, zëri im u mbyllur si në dry,
Kjo ndodh vetëm kur të shoh ty.
E di që çdo fund dhimshëm është,
Por koha që jemi bashkë më pëlqen më së shumti,
Shumë ngadalë koha kalon, e unë nuk po shoh asgjë,
Për pos fytyrës tënde të buzëqeshur
Që dua ta shoh gjithnjë.*

Zëri

*Nëse brenda meje do flisje çfar do të thoje,
Nëse z w brenda meje do te flisje kujt do iu drejtoje,
Nese brenda meje do flisje të fala kujt do i dëgoje,
Nëse brenda meje do flisje të tjereve çfar do iu thoje.*

Pse ti nuk je

*Sonte në mendime jam strukur,
E pranë zjarrit që digjet, në sytë me lot qëndroj.
E duke menduar fjalën që atë ditë ti e the,
Sonte pse ti nuk je një mbrëmje ndryshe,
Një mbrëmje pa hijeshi, pa asgjë,
Gjithçka që ishte, i jepje kuptim ti.*

Rrëfime të shpirtit

*Mos u dorëzoni kurrë, vazhdoni të ndiqni
ëndërat dhe ëndëroni.*



Mesditë

*Mesditë kur kuptova më shumë për veten,
Mesditë kur shikova gjërat për rreth meje,
Mesditë kur më foli një zë brenda meje,
Mesditë kur morra një vendim të ri.*

Je vetvetja

*Ti vetem duhet të jesh vetvetja,
Pavarsisht njerëzve që do ti takosh,
Do përballesh me shumë gjera në jetë,
E do të takosh njerëz të lloj llojshem,
Njerëz që do të duan,
Njerëz që do të urrejnë,
Njerëz që do të bëjnë të ndejhesh ndryshe,
Po në fund të ditës
Secili shikon problemet e veta,
E nuk të pyesin as se si je,
Mos hiq dorë nga ëndërat
Pavarësisht se do nënvlersohesh ,
Prekesh e lëndohesh,
Ti përsëri mos u dorëzo,
Sikur e gjithë bota të të zhgenjej,
Ti mos e zhgenje veten tënde
Vrapo pas ëndrave, se një ditë gjithçka do bëhet realit.*

Largohu

*Ti o njeri që më lë pa fjalë,
Mos fol keq, duke më ardhur vërdallë,
Ti o njeri pa zemër farre,
Që po lëndon çdo kënd,
Dhe s'të vjen keq për askënd,
Mos me dil përballë, të më mashtrosh,
Sikurse nuk ke bërë asgjë,
Ti o njeri me fytyrë ëngjëlli,
E me brendësi djalli,
Njeri më plot fytyra,
Largohu nga unë,
Më mirë të distancuar,
Se sa disa herë e lënduar,
Nga plagët që vetë i ke shkaktuar.*

Sonte

*Sonte një natë shumë e gjatë
Më duket se mëngjesi s'do dal,
Sonte me pyetësorin përball meje
Që duhet të përgjigem çdo pyetjeje,
Sonte pyetjet të janë dedikuar ty
Dhe përgjigja për gjithçka je ti.*

Më lë mua

*Mos u fshih
Ndëgjo veten
Bertirt që zërin tënd,
Ta dëgjojnë të tjerët.
Mos u bë sikur diçka nuk di,
Ti di gjithçka,
Por frika të bën të mendohesh
Se çdo ndodhi pas,
Mos jeto me të kaluarën
Jëto të tashmën, dhe pse një jetë kemi
Jeto e lumtur
Dhe përkushtohu vetes tënde.*

E kupton

*Kur kupton çfar njerëz ke pranë, mërzitësh,
E kupton kur është vonë,
E kupton kur nuk ka vlerë kthimi pas,
E kupton zhgënjimin më të madh*

*Nga personat më të papritur,
E kupton kur dhe prezenca e tyre tek ti,
S'kanë as edhe një pikë vlerë.
E kupton në momentin më të pa përshtatshëm
E kupton por gjithçka është e kotë.*

U shua

*U shua ajo ndjenjë e zjarrtë
Që nuk ia paramendoja fundin,
U shua ajo dashuri
Dhe u mbyll në dry,
U shua ajo e kaluar
Që ishte dikur shumë e çmuar,
U shua ajo veçanti
Ku s'ka më vlere asesi.*

Dedikim për ty

*Në dutet e vetmia
Je mallkuar shumë,
-A di?
Në ditët kur më lëndove
Kam qarë shumë,
-A e di?
Në ditët kur dorëzohesha
Ahh sa jam thyer,
-A e di?
Në ditët ku gjithçka e keqe
Të dedikohej ty.
-A e di?*

Dashuri prindërore

*Burimi dashurisë gjendet tek ju,
Çdo fjalë e ëmbël e veçantë kur përmendet,
Më shkon mendja tek ju,
Jeni thesari më e çmuar në këtë botë,
Jeni personat që shumë ju dua,
Pa ju s'do kishte kuptim jeta ime,
Nënë e Baba vendin më të veçant në zemrën time.*

Për ty

*Më ndalet fryma kur të mëndo,
E s'mund përshkruaj asgjë me fjalë,
Pa të thirrur, pa të kërkuar erdhe vetë tek unë,
Në një fshehtësi të ndritur dashuria po pushton,
Je po ti, pushtues i zemrës time,
Ku po shpejton rrahjet e po shëndrit
Çdo gjë zymtë në zemrën time.*



Çuditërisht

*Diçka brenda vetes më thotë, qetsohu,
Por nuk mundem kur shpirti im është i trazuar,
Çdo ditë mund të vuash, të qajsh e të qeshësh,
Por përsëri do vazhdosh të marresh frymë,
Sikur se s'ndodhi gjë.
Nuk e di ku mund të shoh dicka,
Që se kanë parë syte e mi,
Por në vete ndejë zbraztirë,
Por ëndra ime ka kohë që ka zenë vend,
Habitshëm shikoj për rreth,
E vazhdoj në të njejtën rrugë,
Ku gjithçka po më frikson,
Apo mos ndoshta nga mungesa e vetbesimit në vete
Që po ec me ato hapa e friksuar.*

Prsëri hesht

*Thyhem, lëndohem po te të njejtat gjëra
Por përsëri hesht,
Ndoshta dhe ndihem e dorëzuar nga jeta
Por përsëri hesht,
Them me vete që nuk do bëj të njejtin gabim
Të mësohem nga e kalura
Por unë përsëri hesht,
Është momenti ku ndehejm boshe
Por përsëri hesht,
Është një pjesë e ima që s'mundem ta ndyshoj
Ndjehem e turpëruar dhe nga vetja ime
Që lëndohem nga njerëz të pa vlerë.*

Je vetëvetja

*Mundohu në jetë
Mundohu në jetë t'ia dalish vetë
Munhohu sado pak të shafqesh ajo që je.
Mundohu sa me pak që të lëndoshesh nga të tjerët.
Mundohu të kesh sado pak vetëbesim në vete,
Mundohu sado pak të ndikoshesh nga të tjerët,
Je bota jote dhe vepro si të duash vetë,
Sepse nuk është askush shpëtimtari imagjinar,
Përpos vetes tënde.*

Shiko veten

*Shiko veten para se të gjykosh të tjerët,
Lëndo veten përpara, para se t'i lëndosh të tjerët,
Vendos veten në pozitën e tyre dhe mendo,
Shiko veten përpara dhe pyete se kush je,
Mos vallë je diçka shumë vlershëm,
Mos vallë je çumar shumë, por jo,
Përpos një njeriu nuk je asgjë më shumë,
Edhe nëse je e pasuar e varfër,
Ske asnjë dallim njerzor.
Jemi të gjithë të barabartë.
Prandaj shiko veten.
Sepse vetja përsëri do të fal, ndërsa të tjerët jo.*

Nuk më kupjtojnë

*Sado që mundohem të shprehem
Nuk më kupjtojnë,
Sado që mundohem të flas
Nuk më kupjtojnë,
Sado që mundohem t'ia dal
Nuk më kuptojnë
Nuk marrin paryash agjë nga unë
A thua pse?
Apo mos ndoshta nga të mirat e mia,
Që është të keqen ua kthej me të mirë,
Ndërsa ata më bëjnë të kundërtën,
Por psërsi mendohem dhe pyes veten
Se ku gavova unë,
Mos ndoshta unë isha shkaktar,
E përeëri atë të kaluarën e bëj të haruar.*

Lëndime

*Të jithë lëndojnë
Njeri të pagabueshëm nuk ka*

*Dikë vrasin me plumba
Dikë vrasim me fjalë*

*Dikë vrasim me veprime
E dikë vrasim pa asnjëfjalë.*

*Dikë vrasim pa bërë asgjë
Me gjëra që duhet t'i kishim bërë.*

*Këto janë gracka të jetës
Që bie gjithnjë
Sepse të gabueshëm jemi.*

PROZA

Covit 19

-E dashura ime, në pamundësi të vijë tek ti qoftë edhe për një kafe, duhet të të shkruaj një letër duke e pirë vetë kafën. Shpresoj që kjo letër të të gjeje mirë me shëndet dhe me gjendjen emocionale në nivel. Në gjithmonë kemi qenë bashkë për të mirë e për të keq, por tani jami vetëm. Të gjithë jetojmë në një botë, në të cilën nuk e dimë se çdo të ndodh. Më pas, nuk jemi të sigurtë nga gjërat që ndodhin çdo ditë, po ashtu dhe tani në shekullin 21 na ndodh një gjë e pa pritur, ndodh diçka që preku botën një Virus.

Ehhh kujt mund ti shkonte ndërmend!. –Askujt. Por kjo ndodhi! Me 10 dhjetor të vitit 2019 ky virus në fillim u përhap në Kinë, i emeruar me një emër të panohur edhe për mua si Covid, apo Corona. Gjendja u përkeqësua shumë, por në të vërtetë edhe pse lajmet gjithmon paralajmronin masa, Unë nuk kisha interes farre për këtë dukuri që po na vinte dita ditës edhe në vendet tona. Asnjëherë s'mendoja se virusi do përhapej në të gjithë botën. E kur gjendja filloi të bëhej më serioze atëherë fillova të besoj se virusi egziston dhe filloi të rrirret frika. 15 Marsi nuk ishte ditë e lumtur që po afrohej pranvera, por dita kur virusi arriti dhe tek ne. Gjenda po përkeqësohej edhe me keq, nëpër fytyrat e njerëzeve nuk kishte më lumuri por dëshprim dhe frikë të madhe. Këtu

nis dhe rrugëtimi i një pandemie të madhe dhe fillimi i një jete të re. Për ne nuk ishte e domosdoshme të kesh çantën me vete, apo dicka tjetër, por gjithçka lidhej me maskën. Në këtë pandemi të madhe ne kuptuam edhe më mirë domethënien e familjes. Për këtë arsye këtë letër ta dedikova ty dhe shpresojmë që ky rrugëtim të ketë një fund të mirë të munda të përqafojmë përsëri njerëzit tanë të dashur drejt një të ardhme të lirë dhe të lumtur.

Krijim epistoral

Libri udhërëfyes i diturisë

Jetojmë në një botë përplot mistere ku ajri që thithim është i rëndë dhe i mykur. Ky ajër luhartet, shpërndahet por përsëri ngec, shuhet mes katër mureve, shuhet prapa grilave të shëumtuara të paditurisë.

Ndonjëherë strukem në një skaj dhe mendoj me dëshprim, mbyll sytë dhe vetja më duket si një atom që fluturon në ajër, por nuk arrimë askund pasi dritaret e dituris tonë janë të mbyllura dhe të mykura nga ajri i rrethit ku jetojmë.

Dëshprohem pasi që jetoj në një rreth ku ndryshimet na përplasën si valët e pabesta të detit, ata na marrin dhe na godasin në pikat tona të dobeta. Pse? Pse vallë duhet të jetojmë, dhe të kemi mik paditurinë, pse lejojmë që dituria jonë të shuhet si një fletë që digjet, si një dorëshkrim që ka humbur vlerën ndër vite. Një ditë tek sa po lexoja një revistë më zunë sytë në një artikull, u habita dhe për disa minuta po analizoja titullin. Ishin thjesht disa shkronja me ngjyrë të zezë, disa reshta që diku kishin një përfundim, por këta reshta ishin aq të fuqishme sepse mes tyre përshkruhej diçka, tregohej për disa njerëz që jetën e tyre ia kishin dedikuar diturisë, që shpirin e tyre fisnik ia kishin falur librit mikut të tyre, shokut tim të shejntë që më ka udhëhequr deri më sot. Pas një hamedësimi ngrita sytë dhe para meje qëndronin

disa libra, ishin të heshtur por shëndrisnin pasi me vete kishin dirtë, ato rreze drite që nuk i kisha hasur askund tjetër më parë . Libri? Ç'është vallë libri? Libri është shoku im, shoku që nuk më tradhëton kurr, është ai që kurr nuk më le në baltë, ai që më ngre lartë dhe më bën të ndjehem si pëllumb i lirë që fluturon. Libri është udhërrëfyesi kryesor i dejnë, ai na çon larg pasigurisë dhe drejt diturisë, drejt një botë ku dituria ska fund, ku dituria nuk shihet kurrë. Do të doja të shkruaja akoma, por çdo fjalë e tepër do të shëmtonte bukurinë e asaj që tregova, prandaj po e mbyll me kaq dhe do pres me shpirtë që një ditë kushdo që të lexoj këtë leter të kuptoj atë që me zemer e kamë shkruajtur.

Kam haruar

Kam duruar padrejtësi, e kam duruar gënjeshtër, kam duruar mosrespekt, e kam duruar mos vlerësim . Kam duruar shumë gjëra që nuk është dashur t'i duroj "Sepse kjo jam unë". Kam duruar shumë vetëm për hirë të respektit të dashurisë ndaj njerëzve, që kanë qenë në zemrën time, e vërtet sdoja ti humbisja. Edhe veten e kam shkelur, edhe ndonjëherë skam thënë asgjë, edhe pse kam ditë shumë, edhe pse kam mundur të flas shumë, por përsëri kam vendosur të qëndroj në heshtje. Vetëm për mos me i lënduar njerëzit për rreth meje dhe për të mos i humbur përsëri shikoja anën pozitive të tyre edhe pse ishin të mbushur me negativitet, ajo anë pozitive ishte vetëm një iluzion . Disa gjëra më kanë bërë të ndryshoj, e kam vërejtë që jam një njeri që duroj shumë gjëra negative, shumë gjëra të padrejta, edhe pse skam pasur nevojë t'i duroj as për respekt as për asgjë. Por kjo jam unë, vajza e lumtur që pas asaj lumturie fshihen lotët. Je vetja. Po ashtu kam kuptuar që në jetë nuk vlen asgjë më shumë sesa një zemër e pastër dhe një karakter i fortë dhe i sinqertë. E kam kuptuar që gjeja më e vlershem për veten tënde është dashuria dhe respekti ndaj vetes. Shëndërit dhe koha jote.

Për ju

*Ndoshta tani nuk është koha e duhur, por unë vendosa
t'iu shkruaj juve po sot.
Sot vendosa ta largoj këtë brengë brenda meje dhe pse
është shumë e vështirë të hiqet.
Disa reshta për ne të pandashmet.
Për ne që ishim dhe jemi pesë motra
Fëmija këtu po mbaron dhe gjith secila tani do të
vazhdoj rrugë të ndryshme në jetë .
Ju faleminderit për gjithçka, ju ishit ato që më përkrahet
gjithmonë, e më ngritet kur unë rëzohesha, më ndihmuat
gjithmonë kur kisha vështërsi.
Fjalët janë të pakta për ju motra të mija, për ju që keni
vend shumë të veçantë në zemrën*

Netë që flasin

E dua natën e heshtur të ngadaltë dhe misterioze, nuk dëgjoj asnjë zë njerëzor, gjithçka është nën sundimin e heshtjes dhe qetësisë së shpirtit.

Është ai moment kur e dëgjoj veten dhe vlersoj çdo mendim timin.

Qetësinë apo vetminë apo dhe ëndërat imagjinare, nata është pozitive, është ajo që të vjinë mendime sa andej e kendej.

Është ajo që i them vetes:- Unë jam ndryshe, unë mundem dhe unë jam krenare për personin që do bëhem dhe për atë që jam.

Kjo të jep ndjenjën për të parë brenda, për të komunikuar e krijuar më shumë për veten.

Në atë errësire ku ndriçon vetëm ëndërat dhe shpresa nuk humbet, gjithçka bëhet e lehtë dhe e aritëshme për të arritur në jetë.

Ndryshe

Në brendesinë e shpirtit tim ku mendimet e mia po përplasen me njëra-tjetrën dhe buzëqeshja e buzëve të mia humb.

Në këto rreze dielli ku shpresa ime deprton në mendet e turbullta të imagjinatës, e kupton se gjithçka në jetë kalon dhe gjithçka bëhet sikur të mos kishte ndodhur aspak. Bota ndryshoi shumë, aq më shumë që po kalojnë vitet, edhe njerëzit po distancohen dita ditës. Edhe bukuria e të qenurit të lumtur ka filluar të zbehet.

Gjithçka është kthyer si një teori me baza të mistershme, kjo ndodh sepse në këtë botë kanë humbur vlerën shumë gjëra dhe kanë marrë vlerë të madhe gjëra që s' duhet të kishin aspak vlerë.

Diturija, dritë e mendjes dhe e jetës

Diturija është dritë e jetës tonë, ajo është thesari më i çmuar dhe thesari i një të vërtete të fshehur. Çdo njeri kalon rrugtimin e të ardhmes sepse kemi shumë kushte të cilat duhet ti kryejm, por kemi nevojë për dritën e mendjes ashtu si kemi nevojë për ushqim! Kemi nevojë dhe për dituri.

Kjo dritë na dergon drejtë një të ardhme të mirë, drejt një të ardhme ku nuk do të zhgenjehemi, është një fuqi për tejkalkmin e pengesave , është një shpresë për realizimin e ëndrave .

*Pa dije dhe kuptim , asnjeri nuk zhvillon kulturën që i përket natyrës së tije, si një shprehje e vjetër që thotë :
DINJITETI I NJË NJERIU NUK MATET ME TITUJT
QË ZOTRON, POR ME DIJEN DHE EDUKATEN QË
MERITON*

Drita e hënës

Gjithmonë mendoj gjërat e bukura të cilat i ëndëroj çdo natë nën dritën e hënës, e të cilat më emocionojnë shumë dhe arrijë shumë larg në to . Në një imagjinatë në të cilën mendoja se ishte e vërtetë, në atë dritë të hënës plot shpresë e cila me mburrte të jem vetja gjithmone e te mos humbem kurrë. Të përballem me të gjitha ato çka na ndodhin nga njerëzimi me guxim të fortë. Në një botë krejt ndryshe, në një botë ku nuk mbizotron gjënjeshtra dhe padrejtitë por e vërteta.

Por sa do larg që shkoja, e vëtrteata e hidhur rriktheheshte dhe fillonte përballëj me të.

Jeta

Jeta është e bukur e ne duhet ta shfrytëzojmë atë në mënyrën më të mirë të mundshme, ta jetojmë si duam vetë. Edhe pse ka raste ku ndonjëherë nuk shkon si duam ne dhe mërzitemi ka sfida, edhe pse vetë jeta është një sfidë. Por ka raste kur jemi shumë të lumtur e lëmë gjithçka pas, mendojmë se ajo ndjejnë do zgjat përgjithmonë por gabohemi. Kur rrëzohmi në jetë shpesh, mundohesh të bindësh veten se dita më e bukur nuk ka ardhur ende. Jeton me këtë ndjenjë . Sa më shumë që kalon koha aq më tepër e kupton se mbase ajo as që do të vij më.

Humbasim shpresat dhe ëndërat tona të cilat i thurëm me vite, por shpresa me frikë është dobësi. Frika vjen nga mendimet e frikshme të dështimit. Nuk duhet dorëzuar kurrë, kur rrëzohemi, duhet munduar gjithmonë për gjithçka. Jeta nuk ka asnjë obligim të na ofroj atë që ne presim, por ne duhet ta arrimë vetë për të ardhmen tonë me guxim të plotë dhe vetëbesim sepse gjithçka në këtë jetë është e përkohshme.

Guximi tek një njeri

Ajo çfarë e mban gjallë një njeri dhe e dallon atë nga të tjerët, janë vlerat nga të cilat ai karakterizohet. Një prej atyre vlerave është vlera e guximit. Duhet të kemi guxim të përballojmë çdo situatë me të cilën na përball jeta, nëse humbasim guximin bashkë do humbasim një pjesë të personalitet tonë. Për çdo gjë duhet të guxojmë, duhet të mos nënvlersohemi nga të tjerët, duhet ta lartësojmë vetë veten duke qenë të guximshëm. Duke u bërë guximtar nuk është e sigurt, dhe nuk dihet se a do dalim fitimtar apo humbas. Jeta vetë është sfidë, dhe duhet të përballemi dhe ti pranojmë ato që na vijnë. Po ashtu dhe Shekspiri ka thënë “Kush guxon më tepër nuk është njeri”. Nëse një njeri nuk e di të përdor guximin në mënyrë të mençur, në kohën dhe vendin e duhur atëherë guximi është i dëmshëm për të.

Distanca në mes njerësve

Njeriu është një qenie njerzore që jeton, ka ndejna, ka shpresa dhe çdo herë beson. Pa marrë parasysh jetët e tyre, baticat dhe zbaticat që kanë në jetë e sidomos në këtë kohë është shumë vështirë të jetohet. Atë që e kemi nuk e vlersojmë, atë që se kemi e duam. Zemra rreh në çdo moment, por ka raste kur kjo zemër lëdohet dhe më nuk duron, por ndonjëherë shpreson shumë se mabse do ia arrije qëllimit me kalmin e kohës.

Të gjithë kemi një libër ku fillojmë të mbushim me kalimin e viteve dhe veprimeve tona. Njerëzit çdo ditë po rinë më larg njëri-tjetrit. E gjithë kjo është fundi i hidhur që nuk e duam, por fundin e kësaj botë e sjellim ne me veprimet tona.

Nuk jam vetja

Nuk jam vetja nga të ndodhurat sot. Edhe e lumtur nuk jam, u përballa me të pariturën, me pikëllim. U lëndova aq thellë sa që çdo pikë loti që pikonte ishte e mbushur me kujtime.

E lodhur nga gjithçka dhe nga vetyjeta, e lodhur nga koha, e lodhur nga të gjithë që më rrethojnë, por përsëri pa to nuk mund të jetoj.

E përballur sot me të kaluarën në jetë, do jepja gjithçka ta rriktheja lumturinë, por që gjithçka ishte e paarritshme.

E përballur me momente që të duken si në ëndër, e përballur me ëndrën që në gjum nuk e shoh, e përballur me të gjitha.

Mungesa e një personi

Në terrin e natës, ku po mbizotron heshtja, kisha hyrë në mendime të thella e që nuk mundja të dilja, dhe po mendoja përtej brigjeve të mendimeve të mija, isha e turbullt me veten.

Ndjeja mungesën e një personi!!! Por as vetë nuk e dija se kush!!! E përballur me monologun e konfuzitetit se kush më mungonte mua. Nata kaloi e doli dielli përsëri. Përsëri e njejta rutinë dite. Koha për në shkollë. Ecja rrugës përsëri me mungesen për brenda vetes, e duke vështruar për rreth. Sa po arrita tek dera hyrse mu shfaq përpara syve një imazh vajzeje. U habita shumë sepse nuk e kisha parë asnjeherë më parë. Menjëher vrapova tek ajo ta pyesja se ksuh ishte?

Ajo kishte humur rrugën.

Ajo më thëri motër mua.

Unë u habita, poashtu edhe humba mungesën e një personi. Gjatë kohës që kalum bashkë, ajo parapitur më tha motër. Unë u habita shumë, por isha shumë e lumtur që takova një person si ajo.

-Duhet të shkoj,- më tha.

-Unë në atë moment i thash, jo ri këtu.

-Ajo me tha,- Me duhet të shkoj sepse kalova shumë kohë këtu.

Ajo sapo filloi të etc, gjithçka për rreth meje u bë e turbullt, nuk shihja asgjë, vetëm një mjegull të bardhë para syve të mi, duke kërkuarr për rreth. Ndejva një dorë në supe duke më thënë;

- Zgjohuu, zgjohuuu , ishte zëri i nënës që më thëriste.

Pas pak çastesh u ktheva në realitet dhe kuptova se e gjithë kjo kishte qenë një ëndër, një imagjinatë që më ishte dukur aq e vertetë.

I mirë është ai libër, ku autori thotë atë që duhet dhe ashtu si duhet. – Aristoteli

*Të nderuar lexues së fjaës së bukur
Ju falemenderoj nga zemra që lexuat veprën
time të dytë, ishte kënaqësi të ndaja me Ju të
gjitha këto krijime të veprës sime.*

*Falenderoj më të shtrenjtët e mi, familjen time
që më përkrahin gjatë gjithë kohës.*

*Një falenderim të sinqertë për arsimtarin
Muaxher Haruni, me të cilin kam bashkëpunuar
deri në botimin e kësaj vepre.*

*Me respekt
EMIRA*

Përmbajtja

<i>Ajo ditë</i>	5
<i>Ajo ditë e pa harruar,</i>	5
<i>Më ndihmo</i>	6
<i>Pranoja vetes</i>	7
<i>Ankth</i>	8
<i>Koha</i>	9
<i>Sa vite kaluan</i>	10
<i>Nëna</i>	11
<i>Gjuha e heshtje</i>	12
<i>Poezia</i>	13
<i>Koha</i>	14
<i>Qëllimi i pambaruar</i>	15
<i>Mendime në heshtje</i>	16
<i>Ndoshta</i>	17
<i>Gënjeshtra gjatë gjithë jetës</i>	18
<i>Ajo</i>	19
<i>Për ty</i>	20
<i>Mendimet</i>	21
<i>Mbase</i>	23
<i>Rastësitë</i>	24
<i>Dashuri</i>	25
<i>Udhëpërshkrim</i>	26
<i>E veçantë</i>	27
<i>Shkrime të shoqëruara me lotë</i>	28
<i>E vërtetë e hidhur</i>	29
<i>Ta dije</i>	30
<i>E vetmuar</i>	31
<i>Zëri</i>	32
<i>Pse ti nuk je</i>	33
<i>Mesditë</i>	35

<i>Je vetvetja</i>	36
<i>Largohu</i>	37
<i>Sonte</i>	38
<i>Më lë mua</i>	39
<i>E kupton</i>	40
<i>U shua</i>	41
<i>Dedikim për ty</i>	42
<i>Dashuri prindërore</i>	43
<i>Për ty</i>	44
<i>Çuditërisht</i>	45
<i>Prsëri hesht</i>	46
<i>Je vetëvetja</i>	47
<i>Shiko veten</i>	48
<i>Nuk më kupjtojnë</i>	49
<i>Lëndime</i>	50
<i>Covit 19</i>	52
<i>Libri udhërefyes i diturisë</i>	54
<i>Kam haruar</i>	56
<i>Për ju</i>	57
<i>Diturija, dritë e mendjes dhe e jetës</i>	60
<i>Drita e hënës</i>	61
<i>Jeta</i>	62
<i>Guximi tek një njeri</i>	63
<i>Distanca në mes njerësve</i>	64
<i>Nuk jam vetja</i>	65
<i>Mungesa e një personi</i>	66

Recensent: Muaxher Haruni
Kopertina dhe dizajni: Stefan Grunevski
Rradhitja kompjuterike : Stefan Grunevski
Shtypshkronja: Tringa Design
Tirazhi: 300



Emira Ibishi është semimaturante në Shkollën illore komonale "Fan Noli" të f. Trebosh.

Me krijime poetike, në poezi e prozë, është marrë që në klasën e gjashtë.

Krijimet e saja i ka të botuara edhe te faqja e shkollës.

Poezia e parë e botuar në faqje të shkollës është "Libri im"

me të cilën trason rrugën deri në dalje edhe të veprës së dytë "Në heshtje".

Në dhjetor të vitit 2019 ka promovuar veprën e parë të sajë "Shpresë ardhmërie".

Ka marrë pjesë edhe në shumë aktivitete të organizuara në kuadër të manifestimeve shkollore e jashta shkollore si dhe manifestime tjera në kuadër të bashkësisë vendore të f. Trebosh.

Është anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve "Oeneum"